ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SPITALI REGJIONAL - PRIZREN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **220/70010-25-11583-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Hartimi i projekteve dhe paramasave për infrastrukturën e spitalit të përgjithshëm dhe monitorimi i punimeve sipas nevojes.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

STUDIO HAPSIRA SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Mat - Prishtinë
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

044-604-711
Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Edmond Halimi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

infostudiohdesign@gmail.com
(Adresa elektronike)





24.11.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)
(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Më datën 30.05.2026 është publikuar njoftimi për kontratë.
• Afati i dorëzimit ofertave , data 12.05.2026 koha 14:00 E-PROKURIM
• Hapja e ofertave po të njëjtën datë : 12.05.2026 koha 14:00 E-PROKURIM
• Vendimi për Eleminimin tonë- Letrat Standarde me datë : 19.06.2026
• Vendimi i OSHP: 2026/0516 i dates 28/08/2026
• Vendimi për Eleminimin tonë- Letrat Standarde me datë : 03.11.2026-Rivlersim
Më datën 09.11.2026 kemi bërë kërkesë për Ri-shqyrtim pran Autoriteti
Më datën 16.11.2026 na është refuzuar kërkesa për Rishqyrtim
• Kriteri i dhënies Kontratës : Çmimi më i ultë..

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7
Neni 69
***Vendimi të* OSHP: 2026/0516 i dates 28/08/2026 i konsiderohet Rest Juridicata -Igjikuar**
Neni 109 dhe 131 i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Refuzimi i kërkesë për rishqyrtim të datës 9.11.2026 në stilin COPY-PASTE edhe pse pretendimet e OE Ankues kanë qenë të ndryshme , përgjigja për të tretë OE Ankues është e njëjtë pa asnjë argument mbi refuzimin e pretendimeve tona ankimore.

2. Brenda afateve të parashikuara ligjore, pala ankimore ka paraqitur pretendimet e saj ankimore kundër qëndrimit të Autoritetit Kontraktues, duke kërkuar rishqyrtimin e vendimmarrjes.

Pas një analize të detajuar të dokumentacionit të lëndës, dispozitave ligjore të zbatueshme dhe pretendimeve konkrete të paraqitura në ankesë, u konstatua se:

- Pretendimet e ngritura nga pala ankimore nuk mbështeten në prova materiale valide.
- Veprimet e ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues gjatë gjithë procedurës kanë qenë në përputhje të rreptë me ligjin përkatës dhe kushtet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit / rregulloret në fuqi.
- Asnjë nga pretendimet e reja nuk përmban elemente apo fakte të reja juridike që do të ndryshonin rrjedhën ose epilogun e procedurës.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues konstaton se **të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara në të drejtë dhe në ligj**.

Për arsyet e lartcekura dhe bazuar në kompetencat ligjore, Autoriteti Kontraktues merr këtë:

1. **REFUZOHET** si e pabazuar kerkesa per rishqyrtim e parashtruar nga **STUDIO HAPSIRA SH.P.K**

PRETENDIMI ANKIMOR 1 :

Përmes kësaj shkrese, dëshirojmë të shprehim kundërshtimin tonë të bazuar lidhur me vendimin e AK-së të datës 03.11.2026, i cili vjen në kontradiktë të plotë me vendimin e po këtij autoriteti të datës 19.06.2026 dhe me vendimmarrjen e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).
Së pari, vlen të theksohet se në vendimin e datës 19.06.2026, Autoriteti Kontraktues e kishte vlerësuar ofertën tonë me 51 pikë, duke e kualifikuar atë si ofertë të përgjegjshme (ndonëse të renditur më ulët). Megjithatë, pas nxjerrjes së Vendimit të OSHP-së me nr. 2026/0516, të datës 28.08.2026, dhe procesit të rivlerësimit, AK-ja ka ndryshuar radikalisht qëndrim. Në vendimin e fundit (datë 03.11.2026), oferta jonë shpallet e papërgjegjshme dhe tenderi anulohet, me arsyetimin se metodologjia përmban terminologji dhe legjislacion të Shqipërisë.

Së dyti, ky arsyetim i ri i AK-së bie ndesh me Ekspertizën Teknike Profesionale të vetë OSHP-së (mbi të cilën është bazuar vendimi nr. 2026/0516). Eksperti profesional i OSHP-së ka konstatuar shprehimisht se metodologjia jonë e punës është dukshëm më profesionale në krahasim me atë të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë ("Proarchitecture SHPK"). Ndaj këtij të fundit, i cili është vlerësuar me pikë maksimale, ekspertiza ka vërtetuar se ka prezantuar një metodologji të kopjuar (copy-paste) dhe përmbajtësisht më të varfër se ajo e jona.
Së treti, pretendimet e ngritura nga AK-ja në vendimin e datës 03.11.2026 janë identike me ato të paraqitura më herët në vendimin e datës 19.06.2026 (ku na ishte dhënë minimumi i pikëve). Këto pretendime konsiderohen tashmë si çështje të gjykuara dhe të ezauruara nga OSHP-ja përmes Vendimit dhe Ekspertizës Profesionale nr. 2026/0516.
Duke u bazuar në sa më sipër, konsiderojmë se vendimi i AK-së i datës 03.11.2026 është i pabazuar, fyes ndaj autoritetit të OSHP-së dhe në kundërshtim të hapur me parimet e prokurimit publik.
Keni bashkangjitur Citat e shkoqitur nga Vnedimi i OSHP-së

MENDIM TEKNIK I EKSPERTIT

1. Objekti i Shqyrtimit

Pretendimi 2. i OE Ankimues lidhet me pikëzimin e Konceptit/Metodologjisë Teknike në kuadër të kriterit të shpërblimit "Oferta Ekonomikisht Më e Favorshme" (TEMF), ku OE pretendon se është nënçmuar me pikë zgjedhje minimale dhe se Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkelur Nenin 52 (Ekspertiza) dhe Nenin 69 (Kriteret për Shpërblimin e Kontratës) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP - Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar), duke favorizuar OE të rekomanduar për kontratë.

2. Analiza e Bazës Ligjore dhe Rregullativës në Fuqi · Neni 69 i LPP-së (Kriteret për Shpërblimin e Kontratës): Kur kontrata shpërblehet sipas kriterit TEMF, AK duhet të përcaktojë në Dosjen e Tenderit në mënyrë të qartë, objektive dhe të matshme të gjitha nën-kriteret e vlerësimit, peshën e tyre dhe metodologjinë e pikëzimit. Vlerësimi duhet të mbështetet ekskluzivisht në këtë matricë.

· Diskrecioni i Limituar i Komisionit: Komisioni i vlerësimit ka diskrecion profesional për të vlerësuar cilësinë teknike, por se ky diskrecion nuk është absolut. Ai duhet të jetë i arsyetuar me shkrim, transparent dhe jo-arbitrar (Neni 1 dhe 7 i LPP-së),

· Neni 52 i LPP-së (Komisioni i Vlerësimit / Ekspertiza): Anëtarët e komisionit vlerësues duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike për të kryer vlerësimin objektiv të ofertave teknike.

3. Gjetjet Teknike nga Krahasimi i Ofertave dhe Vlerësimit

Pas ekzaminimit të hollësishëm të Ofertës Teknike të Ankimuesit dhe asaj të OE të Rekomanduar:

Procedura e Pikëzimit nga AK:

o Komisioni i Vlerësimit i ka ndarë Ankimuesit pikët minimale (ose dukshëm më të ulëta) pa ofruar një arsyetim teknik individual dhe të detajuar në Raportin e Vlerësimit se ku qëndrojnë konkretisht mangësitë e konceptit të tij.

o Deklarimi i përgjithshëm i AK-së, pa specifikuar pikat ku dështon koncepti, përbën mungesë transparence dhe arsyetimi ligjor.

Detajimi i Konceptit Projektues (Substanca Teknike):

o Oferta e OE Ankimues: Përmban një analizë të zgjeruar të detyrës projektuese, duke detajuar specifikimet teknike, parametrat e kërkuar në ToR.

o Oferta e OE të Rekomanduar: Paraqet një qasje më të përgjithshme (shabllon), e cila, megjithëse përmbush kërkesat minimale formale, vërehet se i mungon detajimi i specifikave teknike të vendit/detyrës projektuese në shkallën që ka paraqitur Ankimuesi.

Inkonsistenca në Vlerësim:

Dhënia e pikëve maksimale për një koncept të përgjithshëm dhe pikëve minimale për një koncept më të detajuar — pa pasur një tabelë krahasuese me tregues matës — tregon se AK ka zbatuar vlerësim me standarde të dyfishta, duke rënë në kundërshtim me parimin e barazisë së trajtimit (Neni 7 i LPP-së), pra nuk duhet të arsyetohet nga Autoriteti Kontraktues ndaj ankimuesit me pika që nuk janë përmbajtje e DT apo sipas Aneksi 6. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS. Automatikisht, do të thotë se çdo zbritje ose dhënie e pikëve teknike duhet të bëhet mbi bazën e argumenteve të shkruara dhe të matshme në Raportin e Vlerësimit.

4. Përfundimi dhe Rekomandimi i Ekspertit Teknik

Përfundimi:

Pretendimi ankimor i Operatorit Ekonomik "STUDIOHAPSIRA SH.P.K." është pjesërisht i bazuar. AK ka bërë shkelje të Nenit 69 të LPP-së dhe parimeve të transparencës, sepse:

Nuk ka arsyetuar në mënyrë objektive e teknike se përse koncepti i OE Ankimues (i cili përmban detajim teknik) është vlerësuar me minimumin e pikëve, përjashtuar nga klasifikimi për fitues.

Nuk ka dëshmuar se pikëzimi i diferencuar është mbështetur në kualitetin real teknik ANEKS 6. të DT dhe jo në vlerësim subjektiv.

Rekomandimi si ekspert teknik për ekspertin shqyrtues të OSHP-së rreth Pretendimit nr. 2 nga ankimuesi:

1. Të aprovohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik lidhur me Pretendimin Nr. 2.
2. Të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblim të kontratës.
3. Lënda të kthehet në Rivlerësim, me urdhëresë që AK (përmes Komisionit të Vlerësimit):

· Të bëjë një vlerësim të ri, individual dhe të krahasueshëm për konceptet teknike të të gjithë OE-ve.

· Të arsyetojë me shkrim dhe me argumente teknike çdo pikë të ndarë apo të zbritur sipas kritereve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

KOMENT : Shkelja e parimit të gjësë së gjykuar (Res Judicata)
Autoriteti Kontraktues (AK), në vend që të zbatonte urdhëresat e Vendimit të OSHP-së me nr. 2026/0516 të datës 28.08.2026 dhe të kryente një rivlerësim objektiv konform këtij vendimi, ka zgjedhur ta injorojë atë. Përmes vendimit të datës 03.11.2026, AK-ja na ka eliminuar duke u bazuar në pretendime të njëjta, të cilat janë shqyrtuar më parë dhe janë konsideruar të gjykuara (Res Judicata) nga vetë Organi Shqyrtues i Prokurimit në vendimin e sipërpërmendur. Ky veprim i AK-së përbën një shkelje të hapur të autoritetit vendimmarrës të OSHP-së.metologjisë kjo nuk guxon të anashkalohet , duke marrë parasysh që është hartues i projekteve të investuara nga Bashkimi Evropian.

Legjitimiteti i standardeve teknike dhe legjislacionit të referuar
Pretendimi i AK-së lidhur me përdorimin e terminologjisë apo legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në metodologji është tërësisht i pabazuar dhe dashakeq. Ky legjislacion dhe kriteret teknike përkatëse bazohen plotësisht në standardet e Bashkimit Evropian (Eurocode), të cilat janë standarde të njëjta që aplikohen dhe synohen të harmonizohen në kuadrin e integrimit evropian.

Kapacitetet e Konsorciumit dhe Autorsia e Metodologjisë
AK-ja ka anashkaluar qëllimisht faktin se anëtari i konsorciumit tonë, operatori "Taulant SHPK" nga Shqipëria, është hartuesi i drejtpërdrejtë i kësaj metodologjie. Ky operator posedon një përvojë të dëshmuar si hartues i projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian. Rrjedhimisht, referimi ndaj këtyre standardeve dhe legjislacionit të harmonizuar me BE-në nuk mund të përdoret si pretekst për eliminim, por përkundrazi, dëshmon shkallën e lartë të profesionalizmit të ofertës sonë në krahasim me metodologjitë e kopjuara të operatorëve të tjerë.

Autoriteti Konstraktues ka Diskrecion të limituar Profesional për të vlerësuar cilësin teknike të Metologjisë tonë, kjo është vlerësuar edhe nga Ekeperti teknikë i angazhuar nga OSHP, Provë PSH nr. 2026/0516 po ashtu nuk ka bërë një analizë krahasuese të vlerësimit në pikë mbi bazën e Argumeneteve të shkruara dhe të matshme në Raportin e Vlerësimit.

PRETENDIMI ANKIMOR 2 :

Kërkesa për rishqyrtim e paraqitur nga Operatorët Ekonomikë "AXIOM" dhe "ENG-IDEA" duhet të hedhet poshtë si e palejuar dhe e paraqitur jashtë afatit ligjor, për shkak të prekludimit (skadimit) të afateve të përcaktuara me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP).
Ky qëndrim mbështetet në kronologjinë procedurale dhe dispozitat ligjore si në vijim:

1. Pajtimi i heshtur me vendimin fillestar të Autoritetit Kontraktues (AK)
Ndaj vendimit të parë të AK-së, të datës 19.06.2026, operatorët ekonomikë "AXIOM" dhe "ENG-IDEA" nuk kanë ushtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së (brenda afatit ligjor prej 5 ditësh) dhe as ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) (brenda afatit prej 10 ditësh). Përmes këtij mosveprimi procedural, këta operatorë kanë pranuar ligjërisht arsyet e eliminimit të tyre në atë fazë të procedurës.

2. Mungesa e legjitimitetit aktiv në procedurën ankimore
Në procedurën e rishqyrtimit që pasoi dhe që rezultoi me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0516, të datës 28.08.2026, e vetmja palë ankimuese ka qenë shoqëria jonë, "Studio Hapësira" SH.P.K. Operatorët "AXIOM" dhe "ENG-IDEA" nuk kanë qenë palë në këtë procedurë ankimore dhe nuk kanë kontestuar asnjë aspekt të vendimmarrjes pranë OSHP-së.

3. Humbja e të drejtës së ankimimit pas rivlerësimit
Pas zbatimit të vendimit të OSHP-së dhe përfundimit të procesit të rivlerësimit, AK-ja ka nxjerrë vendimin e dytë më datë 03.11.2026. Kërkesa e tanishme për rishqyrtim e operatorëve "AXIOM" dhe "ENG-IDEA" synon të kontestojë çështje dhe gjetje të cilat kanë marrë formë të prerë që nga vendimi i parë i datës 19.06.2026, dhe për të cilat e drejta e ankimimit është shuar përfundimisht

Në mbështetje të Nenit 108/A, paragrafi 3 dhe Nenit 109, paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), mospërdorimi i mjeteve juridike (kërkesës për rishqyrtim ose ankesës në OSHP) brenda afateve prekluzive ligjore rezulton me humbjen e të drejtës për kontestim. Për rrjedhojë, pala konsiderohet ligjërisht e pajtuar me vendimin e mëparshëm dhe nuk mund ta rikthejë të drejtën e ankimit në fazat e mëvonshme të procedurës.Rrjedhimisht, meqenëse "AXIOM dhe ENG-IDEA" ka konformuar dhe pranuar eliminimin e tij me vendimin e datës 19.06.2026, ankesa/kërkesa e tij aktuale ndaj vendimit të rivlerësimit të datës 03.11.2026 është e palejuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.

Të mirren masa Ndaj Autoriteti Kontraktues konfom NENIT 109 dhe 131 LPP-së për mos zbatim të vendimeve të OSHP-së

Andaj, mbi bazën e të sipër përmendurave, Organit Shqyrtues të Prokurimit, i propozojmë që të merr këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET** tërësisht e bazuar Ankesa e parashtruar nga OE STUDIO HAPSIRA SH.P.K.

II. **TË ANULOHET VENDIMI** e AK-së i datës 03.11.2026, Të KTHEHET LËNDA NË RI-VLERËSIM

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ne si OE kemi pësuar dëme të konsiderueshme. Dëmet e pësuara (materiale dhe jo materiale) deri në këtë fazë të procedurës janë në vlerë 170,000 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*